



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Vetëm

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 30 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për parashtrime në lidhje me gjuhën e punës së procesit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit kujdestar të Nasim

Haradinajt

Bastian Martens

GJYKATËSI I VETËM,¹ në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 8(3)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) kërkoi arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) (bashkërisht “të dyshuarit”).²
2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm nxori “Vendimin mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra për transferim” me të cilin urdhëroi arrestimin dhe transferimin e z. Gucati dhe z. Haradinaj.³
3. Më 25 shtator 2020, z. Gucati u arrestua dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.⁴ Z. Haradinaj u arrestua më 25 shtator 2020 dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ditën e nesërme.⁵

¹ KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik, f. 5.

² KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim plotësues urgjent lidhur me parashtrimin e protokolluar KSC-BC-2018-01/F00125*, 23 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-07, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për arrestime dhe transferime*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat e redaktuara publike 1-4.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Hysni Gucati në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00019, Administratorja, *Raport paraprak mbi arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucati në pajtim me vendimin KSC-BC-2018-01/F00128*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00031, Administratorja, *Raport për arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucati në objektin e paraburgimit*, 30 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00016, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00020, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, KSC-BC-2020-07

4. Paraqitja e parë e z. Haradinaj u mbajt më 29 shtator 2020. Paraqitja e parë e z. Gucati është caktuar për 1 tetor 2020.⁶

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Në pajtim me nenin 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja, dhe në çdo procedurë, paneli mund të vendosë për gjuhën e punës gjatë procedurës, sipas nevojës dhe duke respektuar në tërësi të drejtat e të akuzuarve.

6. Në përputhje me rregullën 8(3)(a) të Rregullores, duke marrë parasysh nenin 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

III. DISKUTIM

7. Duke pasur parasysh arrestimin dhe transferimin e z. Gucati dhe z. Haradinaj, është e domosdoshme që të përcaktohet gjuha e punës e procesit aktual për të siguruar kryerjen e drejtë, efikas dhe të shpejtë të tij. Gjithashtu, caktimi i gjuhës së punës është i domosdoshëm për të siguruar sa më herët që është e mundshme gjatë procesit qartësi për palët dhe për çdo pjesëmarrës, sipas rastit, për përgatitjen dhe organizimin e parashtrimeve të tyre. Gjithashtu, përcaktimi i hershëm i gjuhës së punës do të rrisë

me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00021, Administratorja, *Raport paraprak për arrestimin dhe transferimin e Nasim Haradinajt në pajtim me vendimin KSC-BC-2018-01/F00128*, 26 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00026, Administratorja, *Raport i korrigjuar për arrestimin dhe transferimin e Nasim Haradinajt në objektin e paraburgimit*, 28 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ KSC-BC-2020-07, F00023, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë të Nasim Haradinajt*, 28 shtator 2020, publik; F00029, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë të Hysni Gucatit*, 29 shtator 2020, publik.

aftësitë planifikuese të sektorëve të shërbimeve gjuhësore brenda Zyrës Administrative dhe ZPS-së.

8. Gjykatësi i Vetëm thekson se gjuha e procesit deri më tani ka qenë anglishtja, meqenëse të gjitha parashtrimet e ZPS-së dhe të gjitha vendimet dhe urdhrat e Gjykatësit të Vetëm janë dhënë në anglishte. Sidoqoftë, para marrjes së vendimit për përcaktimin e gjuhës së punës së procesit, dhe para se të vendoset nëse ekzistojnë arsye bindëse për mospërdorimin e anglishtes gjatë kryerjes së procesit në të ardhmen, Gjykatësi i Vetëm e konsideron të nevojshme të marrë parashtrime nga palët.

9. Gjykatësi i Vetëm thekson se përcaktimi i gjuhës së punës nuk ndikon në gjuhën dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumenteve të tjera të domosdoshme për përdorim nga të dyshuarit.⁷

IV. VENDIM

10. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm kërkon nga palët që t'i dorëzojnë parashtrimet e tyre në lidhje me gjuhën e punës për t'u miratuar në procesin aktual deri të mërkurën, 7 tetor 2020.

/nëshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Vetëm

E mërkurë, 30 shtator 2020
Në Hagë, Holandë.

⁷ Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.